

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 9 MAJ 2022

Zonja kryesuese e seancës, Kam një parantezë të detyruar. Logjika juridike thotë: seancat si kjo e sotmja kanë kohë të përcaktuar. Koha ndahet në mënyrë të barabartë midis shumicës dhe pakicës. Është e drejta e shumicës se si do ta ndajë kohën mes vetes, por jeni të detyruar të respektoni raportet kohore. Kur ia jepni fjalën një anëtar të kabinetit, jashtë listës së folësve të regjistruar dhe jashtë kohës së përcaktuar për ta, duhet t'i komunikoni seancës se cilit deputet po i hiqet kjo kohë. Kjo është logjikë e thjeshtë juridike, por edhe common sense.

Besoj se nuk duhet ta ndërlikoni zhvillimin e seancës sa herë që e drejtoni ju, sepse mentaliteti parlamentar nuk e pranon të vendosin dhe urdhërojnë një frymë, të cilën ju përpiqeni ta bëni mbizotëruese në drejtimin e kësaj seance. Shumë shkurt: jemi vendi i vetëm që i kemi shpallur luftë besimit fetar gjatë periudhës së regjimit totalitar. Të gjithë prisnim dhe presim, që me vendosjen e demokracisë, po aq sa respektimi i saj, i të drejtave të pluralizmit politik, të të drejtave të njeriut, të respektohen edhe të drejtat fetare. Diskutojmë dhe bëjmë debat të gjerë në komisione, në seancë plenare, në media, në opinionin publik, në lidhje me Butrintin. Ngjitur me hapësirën arkeologjike të Butrintit, kemi edhe një pjesë, e cila ka qenë pjesë e pandarë e Parkut Kombëtar të Butrintit. Kohët e fundit u dha leje nga qeveria për ngritjen e resortit me emrin "Manastiri Resort". Dhe ku do të ndërtohet ai resort, sipas planimetrisë që pamë?

Në pronat e manastirit orthodoks të Shën Gjergjit. Kjo në një kohë që pronat e komuniteteve fetare nuk po kthehen, ashtu siç e kemi për detyrë ta bëjmë. (Bie gongu) I dhunojmë ato në mënyrë flagrante. Dëshiroj të theksoj në sallën plenare dhe të paralajmëroj qeverinë, ministrat përkatës, se këto janë çështje, që nuk do t'i lëmë, nuk kemi ndër mend t'i lëmë të kalojnë ashtu, e jo vetëm në vend, por edhe në instanca ndërkombëtare. Të gjithë ata që përlyhen në afera të tilla duhet ta dinë se qeveria është sot për sot, ndërsa parlamenti është përjetë e mot.